



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e LjUBLANËS), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0453**  
**Data e Vendimit: 17.07.2023**

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenit 109 paragrafi 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092 dhe nenit 64 të Rregullores Nr.002/2022 për Prokurim Publik pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik NTP "BENI", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës" me numër të prokurimit 616-23-781-2-1-1, inicuar Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e autoritetit kontraktues, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me 17/07/2023, mori këtë:

### **Vendim**

Hedhet si e jashtafatshme, ankesa e NTP "BENI" me nr. të protokollit 2023/0453, e datës 03/07/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës", me numër të prokurimit 616-23-781-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

I lejohet, Autoritetit Kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës", me numër të prokurimit 616-23-781-2-1-1, përkritazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

*-Faktet dhe rrethanat procedurale-*

Me 13.06.2023, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e autoritetit kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës” me numër të prokurimit 616-23-781-2-1-11.

Me 19.06.2023 OE NTP " BENI " kishte bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Ndërsa me datë 20.06.2023 AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik si të palejuar.

Operatori ekonomik i pakënaqur me vendimin e AK-Kuvendi i Komunës së Prishtinës ka parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit përmes e-prokurimit me datën 01.07.2023.

*- Administrimi dhe Vlerësimi i provave –*

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit “*Pastrimi i objekteve shkollore -Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës*” me numër të prokurimit 616-23-781-2-1-11”, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e autoritetit kontraktues (AK) ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me 13.06.2023. Kudnër këtij njoftimi është paraqitur kërkesë për rishqyrtim nga operatori ekonomik ankues me datën 19.06.2023 ndërsa me datën 20.06.2023 AK ka refuzuar kërkesë për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Meqënëse vendimi i cituar si më sipër i AK-Kuvendi i Komunës së Prishtinës ishte publikuar me 20.06.2023, afati ligjor për të parashtruar ankesë në OSHP ka filluar të rrjedh nga data 21.06.2023 deri me datën 30.06.2023 ora 16:00.

Zyra për pranimin e ankesave pas pranimit të ankesës ka konstatuar se operatori ekonomik ankues OE NTP " BENI " ka parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datën 01.07.2023, ditë e shtune, ora 12:28. Kurse kjo ankesë ishte pranuar nga Zyra për pranimin e ankesave me 03.07.2023 ditë e hënë me numër protokoli 453/2023. Rrjedhimisht ankuesi ka qenë i obliguar që në pajtim me paragrafin 2 të nenit 109 të LPP-së, brenda afateve ligjore të parashtruar ankesë në OSHP, pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK.

Neni 109 paragrafi 2 i LPP-së përcakton se *Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Po ashtu, edhe neni 64.1 në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcaktohen se: Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të nxjerrë nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së.*

*-Përfundimi-*

Mbi bazën e të lartëcekurave konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datë 03.07.2023 nga OE NTP "BENI" për aktivitetin e prokurimit "Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës" është e jashtafatshme sepse ankuesi nuk ka parashtruar ankesën brenda afateve ligjore kundër njoftimit të Autoritetit Kontraktues. Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore, ankuesi mund të drejtohet me ankesë OSHP-së. Si përfundim ankesë është parashtruar në kundërshtim me nenin 109 të Ligjit për Prokurim Publik dhe nenit 64 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, si e tillë hedhet si e jashtafatshme dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Autoritetit kontraktues –Kuvendi i Komunës së Prishtinës, mund të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit (e përshkruar me sipër) nëse nuk ka ankesë tjetër për këtë aktivitet. Paneli Shqyrtues megjithatë i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK duhet të veprohet konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60, 65 të LPP-së.

Lidhur me tarifën ankimore vendoset në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, që operatorit ekonomik ankues ti kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - NTP " BENI "**
- Arkivës së OSHP-së: